# DËSHMI ARKIVI

**A-469736**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Virusi i falsifikimeve ‘sulmon’ Zvicrën, pas Xhakës, edhe Embolo jashtë ekipit për mashtrim! \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/virusi-i-falsifikimeve-sulmon-zvicren-pas-xhakes-edhe-embolo-jashte-ekipit-per-mashtrim/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 17:31:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 17:24:08 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `164ec0ec009c62aaab32749d7ff97dc71914911e519b9f8727bc93283b205897` |
| TEKSTI | `928741d3c86bc63ca7fb56d867e0e7ffbb8bd8b0565f97d47b646b037e47f619` |
| PAMJA | `b3b8929b7a768d974665e93d5c281fc88df46ab4fd3db287ce045f1a3dc466f0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `995e28f08a0b8ec53b4f9edbf166cacac93312a454a7bdc35fbb45dd89e5a2f4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b795f32e8dccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/995e28f08a0b8ec53b4f9edbf166cacac93312a454a7bdc35fbb45dd89e5a2f4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Sport

## Virusi i falsifikimeve 'sulmon' Zvicrën, pas Xhakës, edhe Embolo jashtë ekipit për mashtrim!



*Ervin Nikolla*

*25 Shtator 2026*




Skandali i certifikatave të rreme të vaksinimit trondit sërish Kombëtaren e Zvicrës, teksa pas **Granit Xhakës**, një tjetër emër i madh është përfshirë në të njëjtën vorbull telashe.

Bëhet fjalë për sulmuesin e njohur Breel Embolo, i cili është vënë në qendër të vëmendjes dhe është larguar/pezulluar nga grumbullimi i Zvicrës.

Embolo pritet të humbasë ndeshjet e radhës të ekipit kombëtar në Ligën e Kombeve, pasi mësohet se sulmuesi është penalizuar dhe gjobitur tashmë nga gjykatat zvicerane për përdorim të **dokumenteve false** (falsifikim të certifikatës së Covidit). Ky zhvillim vjen menjëherë pas bujës që bëri pranimi i fajit dhe largimi i kapitenit Granit Xhaka për të njëjtën arsye, duke shkaktuar një goditje të rëndë sportive dhe imazhi për Federatën Zvicerane të Futbollit.

Granit Xhaka në ditët e fundit ka qenë në vorbullën e polemikave pas hetimeve ndaj tij në lidhje me çertifikatën e vaksinimit ndaj Covid 19. Mesfushori pranoi se kishte blerë një çertifikatë të tillë dhe pas një akordi me Federatën Zvicerane u vendos që ai të qëndronte jashtë skuadre në ndeshjet e Nations League.

Megjithatë ka nga ata që i dalin në mbrojtje kapitenit të skuadrës helvete siç është rasti i ish futbollistit të kësaj skuadre Benjamin Huggel.

Ky i fundit në një intervistë për "Neue Zürcher Zeitung" deklaroi se Granit Xhaka duhet të vazhdojë të jetë ende kapiten i kombëtares zvicerane, nëse çështja nuk sjell pasoja të tjera juridike apo sportive.

> *'Nëse nuk ka pasoja të tjera juridiko-sportive dhe çështja trajtohet ligjërisht si e mbyllur në*

*planin penal, unë them krejt qartë: Po-tha teksa iu përgjigj pyetjes nëse Xhaka duhet të vazhdojë të mbajë shiritin e kapitenit- Kapiteni caktohet nga skuadra dhe nga trajneri, jo nga opinioni publik. Nëse trajneri kombëtar Murat Yakin dhe këshilli i skuadrës, pas një bisede të sinqertë dhe të hapur, arrijnë në përfundimin se Xhaka duhet të vazhdojë të jetë kapiteni i tyre, unë nuk shoh asgjë që mund ta pengojë këtë'.*

Huggel shtoi se çështja e certifikatës së vaksinimit nuk duhet të lidhet me mënyrën se si Xhaka sillet në fushën e lojës.

> *'Për mua, një certifikatë e falsifikuar e Covidit nuk do të ishte në asnjë mënyrë arsye për të mos i besuar më si kapiten në fushë. Falsifikimi i pretenduar i dokumentit nuk ka asnjë lidhje me sjelljen e Xhakës në fushë-tha ai.*

#### LAJME TË NGJASHME



Formula 1/ Kualifikueset në Azerbajxhan, Antonelli përplaset me murin, Russell fiton pole position!

1 MIN




Manchester City shpallet fajtor për 114 nga 115 akuzat, rrezikon rënien nga Premier League!

2 MIN




'FIFA duhet të reformohet për të mirën e futbollit'/ Ligat e mëdha evropiane kërkojnë ndryshime në qeverinë e futbollit botëror

4 MIN



Ish futbollisti i Zvicrës i del në krah Xhakës: Duhet të vazhdojë të mbajë shiritin e kapitenit nëse…

1.5 MIN



Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në Europian

1.5 MIN

#### MË TË LEXUARAT



Arrestohet Susan Sarandon/Protestoi kundër Netanyahu-t në OKB!



Lonely Planet zbulon destinacionet më të mira për 2027-ën!



Nations League, Kosova debuton me fitore!



Italia ndalon burkën në shkolla/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!



Parada Seksi e Yjeve: kush do të digjet nga dashuria këtë fundjavë!









Si i jep fund marrëdhënieve secila shenjë e zodiakut!



55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjalën e gjallë pas një dite!



Në këtë vend mendojeni dy herë para se të dëgjoni muzikë me zë të lartë, do të gjobiteni!



Agim Ademi, mesazh emocionues pas fitores së "Dardanëve"!



Rama në Këshillin Europian të Korporatave: Paqja, kusht për zhvillimin ekonomik!

## EDITORI SUGJERON



Një ilaç i ri për kancerin e pankreasit mund t'u japë pacientëve më shumë kohë!



"Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe…"/ Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?



A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballet me tundimet seksuale: Edhe tani me vajza të bukura…



"Më bezdis përndjekja..."/Ina Aderi: Më kanë ngacmuar personazhe, do dashurohem larg kamerave...




Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...



Mund t'u mungosh shumë, por mesazhin mos e prit! 3 shenjat e horoskopit që nuk bëjnë kurrë hapin e parë...



Fenomeni "pocketing"/ Kur partneri të mban sekret dhe askush në jetën e tij nuk e di që ekziston...



Pse disa njerëz ecin nëpër shtëpi ndërsa flasin në telefon? Arsyeja pse e bëjnë këtë pa e kuptuar është...



"Goca dhe Gra" rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatoret e sezonit të ri?

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.